Neni 12 [Pushteti Lokal] Neni 123 [Parimet e Përgjithshme] Neni 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale]

**KO145/21, parashtues i kërkesës: Komuna e Kamenicës, vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr. 01B/24 të 23 prillit 2021**

Organizimi i mësimit alternativ të përshpejtuar dhe përcaktimi i organizimit të mësimit në objektet përkatëse shkollore në një komunë nga MASHTI, cenon përgjegjësitë komunale dhe kompetencat vetanake të Komunës lidhur me ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, në kundërshtim me garancitë kushtetuese e ligjore: - shkelje e të drejtave kushtetuese.

**Faktet**

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me riorganizimin e shkollave në Komunën e Kamenicës në vitin 2019, riorganizim ky i cili ishte iniciuar përmes vendimeve përkatëse të Kryetarit të Komunës, ndër tjerash, me arsyetimin e rënies së numrit të nxënësve në disa shkolla dhe mungesës së infrastrukturës së mirëfilltë të institucioneve arsimore. Fillimisht, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kishte konstatuar se vendimet përkatëse ishin nxjerrë në përputhshmëri me ligjet e aplikueshme, përkatësisht kompetencat vetanake të komunave dhe MASHTI kishte inspektuar zbatueshmërinë e këtyre vendimeve. Megjithatë, disa prindër të nxënësve të afektuar kishin refuzuar zbatimin e këtyre vendimeve dhe kishin kontestuar të njëjtat përmes konfliktit ad-

Çlan 12 [Lokalna Vlast] Çlan 123. [Osnovna Načela] Çlan 124. [Organizovanje i Funkcionisanje Lokalne Samouprave]

**KO145/21, Podnosilac zahteva: Opština Kamenica, Ocena ustavnosti odluke Ministarstva obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije. br. 01B/24 od 23. aprila 2021.**

Organizacija alternativne ubrzane nastave i određivanje organizacije nastave u dotičnim školskim objektima u jednoj opštini od strane MONTI, krši opštinske odgovornosti i sopstvene nadležnosti Opštine u vezi sa pružanjem predškolskog javnog obrazovanja, osnovnog i srednjeg, protivno ustavnim i zakonskim garancijama; - povreda ustavnih prava.

**Činjenice**

Okolnosti konkretnog slučaja povezane su sa reorganizacijom škola u opštini Kamenica iz 2019. godine, a koja reorganizacija je pokrenuta relevantnim odlukama predsednika opštine, između ostalog, sa obrazloženjem da se broj učenika u pojedinim školama smanjio i da ne postoji odgovarajuća infrastruktura obrazovanih ustanova. Na početku, Ministarstvo administracije lokalne samouprave je utvrdilo da su relevantne odluke donete u saglasnosti sa važećim zakonima, odnosno sopstvenim nadležnostima opština i da je MONTI sproveo inspekciju izvršenja ovih odluka. Međutim, nekoliko roditelja pogođenih učenika su odbili izvršenje ovih odluka i osporili iste u upravnom sporu, tražeći i da se donesu privremene mere radi obustave izvršenja odluka Opštine. Vrhovni sud je, na osnovu spisa predmeta, odbio obustavu izvršenja predmetnih odluka. S obzirom na to da izvesni broj učenika nije pohađao nastavu prema

ministrativ, duke kërkuar edhe nxjerrjen e masave të përkohshme me qëllim të pezullimit të zbatimit të vendimeve të Komunës. Gjykata Supreme, bazuar në shkresat e rastit, kishte refuzuar pezullimin e zbatimit të vendimeve përkatëse. Duke marrë parasysh që një numër nxënësish nuk vijuan mësimin sipas përcaktimeve të vendimeve të Komunës, në vitin 2021, MASHTI kishte formuar një komision për të vlerësuar mosvijueshmërinë e mësimin nga ana e 441 nxënësve, i cili, ndër tjerash, kishte rekomanduar që për të adresuar situatën, MASHTI dhe Komuna duhet të: (i) ndërmarrin veprime të harmonizuara; dhe (ii) të themelojnë grup punues për analizimin e situatës në shkollë. Megjithatë, MASHTI, nxori vendimin e kontestuar, bazuar në të cilin organizoi “mësimin alternativ të përshpejtuar për 441 nxënësit e Komunës së Kamenicës”. Këtë vendim, Komuna e Kamenicës e kontestoi para Gjykatës, duke pretenduar se përmes tij, MASHTI kishte ndërhyrë në kompetencat vetanake të Komunës dhe rrjedhimisht kishte cenuar përgjegjësitë komunale në kundërshtim me garancitë kushtetuese.

#### Ankesat e parashtruesit të kërkesës

Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar i MASHT-it ka cenuar përgjegjësitë e tij komunale në shkelje të neneve 12, 123 dhe 124 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 2 (Baza Kushtetuese dhe Ligjore e Vetëqeverisjes Lokale) dhe nenin 4 (Fushëveprimi i Vetëqeverisjes Lokale) të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, duke theksuar, në esencë se (i) Vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me nenin 12 të Kushtetutës në ndërlidhje me paragrafin (h) të nenit 17 (Kompetencat Vetanake) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (në tekstin e mëtejshëm: LVL), sepse bazuar në këtë dispozitë, komuna ka kompetencë të plotë dhe ekskluzive të ofrojë arsimin publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore; (ii) bazuar në ligjet e aplikueshme, MASHTI nuk ka kompetencë të

utvrđenjima odluka Opštine, 2021. godine, MONTI je formirao Komisiju za procenu nepohađanja nastave od strane 441 učenika, koja je, između ostalog, preporučila da radi rešavanja situacije, MONTI i Opština treba da: (i) preduzimaju usaglašene radnje; i (ii) osnuju radnu grupu radi analize situacije u školama. Međutim, MONTI je doneo osporenu odluku na osnovu koje je organizovao “ubranu alternativnu nastavu za 441 učenika opštine Kamenica”. Ovu odluku je opština Kamenica osporila pred Sudom, navodeći da se njome MONTI umešao u sopstvene nadležnosti opštine, i da je samim tim povredio opštinske odgovornosti u suprotnosti sa ustavnim garancijama.

#### Žalbe podnosioca zahteva

Podnosilac zahteva tvrdi da su osporenim odlukom MONTI-a povređene njegove opštinske odgovornosti u suprotnosti sa članovima 12, 123. i 124. Ustava u vezi sa članom 2. (Ustavni i pravni okvir lokalne samouprave) i članom 4. (Obim lokalne samouprave) Evropske povelje o lokalnoj samoupravi, navodeći, u suštini, da je: (i) osporena odluka doneta u suprotnosti sa članom 12. Ustava u vezi sa stavom (h) člana 17. (Izvorna nadležnost) Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi (u daljem tekstu: ZLSU), jer na osnovu ove odredbe opština ima potpunu i isključivu nadležnost da pruža predškolsko, osnovno i srednje javno obrazovanje, uključujući registrovanje i licenciranje obrazovnih ustanova; (ii) na osnovu važećih zakona, MONTI nema nadležnost da organizuje alternativnu ili dopunsku nastavu i samo može da traži od opštine da organizuje ovu vrstu nastave; i (iii) MONTI nema nadležnost da određuje lokacije obrazovnih ustanova, niti da obavezuje opštinu da održava alternativnu nastavu u obrazovnim ustanovama koje su nelicencirane i koje više ne postoje kao školski objekti. Protivargumentima MONTI-a se, između ostalog, naglašava da se on prilikom donošenja osporene odluke oslonio na Uredbu Vlade br. 02/2021 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava i da smatra da je u skladu sa međunarodnim načelima za zaštitu ljudskih prava, obaveza države da obezbedi primenu osnovnog prava na obrazo-

organizojë mësim alternativ ose plotësues dhe vetëm mund të kërkojë nga komuna që të organizojë këtë lloj mësimi; dhe (iii) MASHTI nuk ka kompetencë për të caktuar lokacionet e institucioneve arsimore e as të obligojë komunën që të mbajë mësim alternativ në institucione arsimore të palicencuara, të cilat nuk ekzistojnë edhe më tutje si objekte shkollore. Kundërargumentet e MASHTI-it, ndër tjerash, theksuan se në nxjerrjen e vendimit të kontestuar është bazuar në Rregulloren e Qeverisë nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dhe konsideron se është obligim i shtetit, që në pajtim me parimet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të sigurojë zbatimin e të drejtës themelore për arsim, respektivisht duke siguruar qasje në institucionet e arsimit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, përmes komenteve të dorëzuara në Gjykatë, mbështeti argumentet e MASHTI-it.

#### Gjetjet e Gjykatës lidhur me pranueshmërinë e kërkesës

Pas parashtrimit të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar nga Kryetari i Komunës së Kamenicës, z. Qëndron Kastrati, më 17 tetor 2021, respektivisht 14 nëntor 2021, pas zhvillimit të raundit të dytë të zgjedhjeve lokale në Republikën e Kosovës, Kryetar i Komunës së Kamenicës u zgjodh z. Kadri Rahimaj. Ky i fundit, përmes përfaqësuesit të tij, më 5 janar 2022, parashtroi në Gjykatë kërkesën për tërheqje të lëndës KO145/21, me arsyetimin se nuk ka interes juridik për shqyrtimin e saj. Gjykata, bazuar në rregullin 35 (Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, sipas të cilit, pavarësisht kërkesës për tërheqje, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë përkitazi me kërkesën fillestare, fillimisht vlerësoi kërkesën e Kryetarit të ri të Komunës, por vendosi të refuzojë të njëjtën, duke pasur parasysh interesin publik për vazhdimin e shqyrtimit dhe vendosjes meritore në rast, me theks në rëndësinë e

vanje, odnosno da obezbedi pristup obrazovnim ustanovama. Ministarstvo administracije lokalne samouprave svojim komentarima dostavljenim Sudu podržalo je argumente MONTI-a.

#### Nalazi Suda u vezi prihvatljivosti zahteva

Nakon podnošenja zahteva za ocenu ustavnosti osporene odluke od strane predsednika opštine Kamenica, g. Qëndrona Kastratija, dana 17. oktobra 2021. godine, odnosno 14. novembra 2021. godine, nakon sprovođenja drugog kruga lokalnih izbora u Republici Kosovo, za predsednika opštine Kamenica izabran je g. Kadri Rahimaj. Poslednje pomenuti je preko svog zastupnika, dana 5. januara 2022. godine, podneo Sudu zahtev za povlačenje predmeta KO145/21, sa obrazloženjem da ne postoji pravni interes za njegovo razmatranje. Na osnovu člana 35. (Povlačenje, odbijanje i odbacivanje zahteva) Poslovnika, prema kojem bez obzira na zahtev za povlačenje Sud može odrediti da odluči o prvobitnom zahtevu, Sud je prvo ocenio zahtev novog predsednika opštine, ali je odlučio da isti odbije s obzirom na javni interes za nastavak razmatranja i meritornog odlučivanja u predmetu, sa naglaskom na važnost razjašnjenja navoda o povredi ustavnih načela koja se odnose na lokalnu samoupravu.

#### Nalazi Suda u vezi merituma zahteva

Prilikom ispitivanja navoda podnosioca zahteva, Sud je prvo razmotrio opšta načela koja se odnose na lokalnu samoupravu utvrđena Ustavom, Evropsku povelju o lokalnoj samoupravi, relevantna mišljenja Venecijanske komisije u vezi sa načelima lokalne samouprave, kao i važeće zakone koji konkretizuju nadležnosti opštine i MONTI-a u oblasti obrazovanja, odnosno ZLSU, Zakon br. 04/L-032 o preduniverzitetskom obrazovanju (u daljem tekstu: Zakon o o preduniverzitetskom obrazovanju) i Zakon br. 03/L-068 o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo. Sud je na osnovu članova 12, 123. i 124. Ustava, respektivno, između ostalog, naglasio: (i) da su opštine osnovna teritorijalna jedinica lokalne samouprave u Republici Kosovo; (ii) da se organizovanje i nadležnosti jedinica lokalne samouprave uređuju zakonom i da se osnivanje opština, granice, nadležnosti i način

qartësimi të pretendimeve për shkelje të parimeve kushtetuese lidhur me vetëqeverisjen lokale.

#### Gjetjet e Gjykatës lidhur me meritat e kërkesës

Në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht shqyrtoi parimet e përgjithshme përkitazi me vetëqeverisjen lokale të përcaktuara me Kushtetutë, Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, Opinionet relevante të Komisionit të Venecias lidhur me parimet e qeverisjes lokale, si dhe ligjet e aplikueshme që konkretizojnë kompetencat e Komunës dhe MASHTI-it në fushën e arsimit, përkatësisht LVL-në, Ligjin nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Arsimin Parauniversitar) dhe Ligjin nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës.

Gjykata, duke u bazuar në nenet 12, 123 dhe 124 të Kushtetutës, respektivisht, ndër të tjerash, theksoi se (i) njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë komunitet; (ii) organizimi dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale rregullohen me ligj dhe themelimi i komunave, kufijtë, kompetencat dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre, rregullohet me ligj; (iii) komunitet kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin; dhe (iv) rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën dhe me ligjin. Për më tepër, bazuar në këto nene kushtetuese, Gjykata theksoi që veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Kjo e fundit, ndër të tjerash, dhe për aq sa është e rëndësishme për rrethanat e rastit konkret, përcakton që: (i) autoritetet lokale, brenda kufijve të ligjit, do të kenë diskrecionin e plotë për të ushtruar iniciativën e tyre në lidhje me çdo çështje që nuk përjashtohet nga kompetenca e tyre dhe nuk i është caktuar ndonjë autoriteti tjetër; (ii) kompetencat që u besohen autoriteteve lokale

njihovog organizovanja i funkcionisanja uređuju zakonom; (iii) da opštine imaju svoje, proširene i poverene nadležnosti u skladu sa zakonom; i (iv) da je administrativno razmatranje akata opština od strane centralnih organa u oblasti njihove nadležnosti, ograničeno na osiguranje saglasnosti sa Ustavom i zakonom. Pored toga, na osnovu ovih ustavnih članova, Sud je istakao da se delatnost organa lokalne samouprave zasniva na Ustavu i zakonima Republike Kosovo i poštuje Evropsku povelju o lokalnoj samoupravi. Poslednje pomenuta, između ostalog, i u meri u kojoj je to relevantno za okolnosti konkretnog slučaja, utvrđuje: (i) da lokalne vlasti, u okviru zakonskih ograničenja, imaju punu slobodu odlučivanja o inicijativama u vezi sa bilo kojim pitanjem koje nije isključeno iz njihove nadležnosti i nije dodeljeno nekom drugom organu; (ii) da ovlašćenja koja se daju lokalnim vlastima po pravilu moraju biti potpuna i ekskluzivna i ne smeju biti narušavana ili ograničena drugom, centralnom ili regionalnom vlašću, osim u skladu sa zakonom; i (iii) da svaki administrativni nadzor nad lokalnim organima može biti ostvaren samo u skladu sa procedurama i u slučajevima koji su predviđeni Ustavom ili zakonom.

Lokalna samouprava ima toliku važnost u ustavnom poretku da je Ustav: (i) utvrdio ove garancije, između ostalog, u svojim osnovnim odredbama; (ii) utvrdio poštovanje Evropske povelje o lokalnoj samoupravi; i (iii) u cilju osiguranja zaštite ovih garancija, u svom članu 113, dao opštinama direktan pristup Ustavnom sudu, u svojstvu ovlašćenih strana da ospore ustavnost zakona ili akata Vlade koji povređuju opštinske odgovornosti ili umanjuju prihode opštine, ukoliko taj zakon ili akt utiče na dotičnu opštinu.

U skladu sa gore navedenim garancijama Ustava i Evropske povelje o lokalnoj samoupravi, i pozivanje istih na obavezu da se ove garancije sprovedu i kroz primenjivih zakona, Sud je takođe podsetio da na osnovu člana 17. ZLSU, opštine imaju “potpune i isključive” nadležnosti u pružanju predškolskog, osnovnog i srednjeg obrazovanja, uključujući i registrovanje i licenciranje obrazovnih ustanova, prijem radnika, isplatu plata i obučavanje instruktora i ad-



normalisht duhet të jenë të plota dhe ekskluzive dhe se ato nuk mund të minohen apo të kufizohen nga një autoritet tjetër, qendror apo rajonal përveç siç përcaktohet me ligj; dhe (iii) çdo kontroll administrativ mbi autoritetet lokale mund të ushtrohet vetëm sipas formave dhe në rastet e parashikuara nga Kushtetuta ose nga ligji.

Vetëqeverisja lokale është e një rëndësie të tillë në rendin kushtetues, sa që Kushtetuta (i) ka përcaktuar këto garanci, ndër tjerash, në Dispozitat Themelore të saj; (ii) ka përcaktuar respektimin e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale; dhe (iii) me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së këtyre garancive, në nenin 113 të saj, i ka dhënë komunave qasje të drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese, në cilësi të palëve të autorizuar, që të kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt. Në përputhje me garancitë e lartcekura të Kushtetutës dhe Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale dhe referimin e të njëjtave në detyrimin që këto garanci të zbatohen edhe përmes ligjeve të aplikueshme, Gjykata gjithashtu rikujtoi që bazuar në nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, komunat kanë kompetenca “të plota dhe ekskluzive”, në ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit. Në anën tjetër, MASHTI, bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe Ligjin për Arsimin në Komunitet, ndër tjerash, mban përgjegjësinë kryesore për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar dhe ka përgjegjësinë të promovojë dhe të përmirësojë cilësinë dhe efikasitetin e arsimit dhe aftësimin përmes inspektimit të arsimit, monitorimit dhe vlerësimit me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe mbikëqyrjes së zbatimit të legjislativnit në fuqi. Në kontekst të raporteve të inspek-

ministratora za obrazovanje. S druge strane, MONTI, na osnovu Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju i Zakona o obrazovanju u opštinama, između ostalog, ima primarnu odgovornost za planiranje, utvrđivanje standarda i obezbeđivanje kvaliteta sistema preduniverzitetskog obrazovanja i ima odgovornost da promoviše i unapređuje kvalitet i efikasnost obrazovanja i osposobljavanja putem inspekcije obrazovanja, nadgledanje i procenu u cilju povećanja kvaliteta i nadzora nad sprovođenjem važećeg zakonodavstva. U kontekstu izveštaja nadležnih inspektorâ, kako je utvrđeno u članu 8. (Inspekcija obrazovanja) Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju, i u meri u kojoj je to relevantno za okolnosti konkretnog slučaja, MONTI može da traži sprovođenje dodatne ili alternativne nastave u slučaju da se primete nedostaci u primeni nastavnog plana i programa u određenoj opštini. U tom kontekstu, Sud je istakao: (i) da pružanje predškolskog, osnovnog i srednjeg javnog obrazovanja na osnovu ZLSU predstavlja sopstvenu nadležnost opštine i da su te nadležnosti potpune i ekskluzivne; i (ii) da u svojoj inspekcijskoj ulozi, kako je utvrđeno u Zakonu o preduniverzitetskom obrazovanju, MONTI “može da zatraži dodatnu ili alternativnu nastavu”, u slučaju kada se primete nedostaci u primeni nastavnog plana i programa. U okolnostima konkretnog slučaja, relevantnim izveštajem Komisije MONTI-a od 14. aprila 2021. godine je, između ostalog, preporučeno preduzimanje usaglašenih radnji između Ministarstva, Opštine i roditelja, “kako bi se omogućilo momentalno vraćanje učenika u škole”. Međutim, pozivajući se na gore navedenu Uredbu Vlade, MONTI je doneo osporenu odluku, kojom je, između ostalog, sam organizovao ubrzanu alternativnu nastavu za opštinu Kamenica, utvrdivši da se nastava organizuje u pet (5) datih škola opštine Kamenica, koje škole je podnosilac zahteva svojim odlukama prethodno reorganizovao kao deo svoje reforme.

#### Zaključak

Nakon analize ustavnih načela i načela Evropske povelje o lokalnoj samoupravi i važećih zakona i prema objašnjenjima datim u objavljenoj presudi, Sud je,

torëve përkatës, siç është përcaktuar në nenin 8 (Inspektimi i Arsimit) të Ligjit për Arsimin Paruniversitar, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, MASHTI mund të kërkojë zbatimin e mësimit shtesë ose alternativ, nëse vërehen mangësi në zbatimin e kurrikulumit në një komunë.

Në këtë kontekst, Gjykata theksoi se: (i) ofrimi i arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, bazuar në LVL-në, është kompetencë vetanake e Komunës dhe se këto kompetenca janë të plota dhe ekskluzive; dhe (ii) në rolin e saj inspektues, siç është përcaktuar në Ligjin për Arsimin Paruniversitar, MASHTI “mund të kërkojë zbatimin e mësimit shtesë ose alternativ”, në rast se vërehen mangësi në zbatimin e kurrikulumit. Në rrethanat e rastit konkret, raporti përkatës i Komisionit të MASHTI-it i 14 prillit 2021, ndër të tjera, kishte rekomanduar ndërmarrjen e veprimeve të harmonizuara në mes Ministrisë, Komunës dhe prindërve, “që të mundësohet kthimi i menjëherëshëm në shkolla i nxënësve”. Megjithatë, duke u referuar në Rregulloren e lartcekur të Qeverisë, MASHTI kishte nxjerrë vendimin e kontestuar, përmes të cilit, ndër tjerash, kishte organizuar mësim alternativ të përshpejtuar për Komunën e Kamenicës, duke vendosur që të organizohet mësimi në pesë (5) shkolla përkatëse të Komunës së Kamenicës, shkolla këto që paraprakisht parashtruesi i kërkesës i kishte riorganizuar përmes vendimeve, si pjesë e reformës së tij.

#### Përfundimi

Pas analizës së parimeve kushtetuese, atyre të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjeve të aplikueshme dhe sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata, ndër tjerash, theksoi se me rastin e organizimit të mësimit alternativ të përshpejtuar dhe përcaktimit të organizimit të mësimit në objektet përkatëse shkollore në Komunën e Kamenicës, MASHTI përmes vendimit të kontestuar, ka tejkaluar kompetencën e saj dhe ka cenuar përgjegjësitë komunale, përkatësisht ka ndërhyrë

između ostalog, naglasio da je prilikom organizovanja ubrzane alternativne nastave i utvrđivanja organizovanja nastave u odgovarajućim školskim objektima u Opštini Kamenica, MONTI osporenim odlukom prekoračio svoju nadležnost i povredio opštinske odgovornosti, odnosno umešao se u sopstvene nadležnosti Opštine Kamenica koje se odnose na pružanje javnog predškolskog, osnovnog i srednjeg obrazovanja, u suprotnosti sa ustavnim i zakonskim garancijama. Sud je istakao važnost poštovanja ustavnih načela koja se odnose na lokalnu samoupravu i obavezu centralne vlasti da svaki administrativni nadzor nad lokalnim vlastima vrši samo u formama i u slučajevima predviđenim Ustavom ili važećim zakonom.

në kompetencat vetanake të Komunës së Kamenicës përkitazi me ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, në kundërshtim me garancitë kushtetuese dhe ligjore. Gjykata theksoi rëndësinë e respektimit të parimeve kushtetuese përkitazi me vetëqeverisjen lokale dhe detyrimin e pushtetit qendror që çdo kontroll administrativ mbi autoritetet lokale ta ushtrojë vetëm sipas formave dhe në rastet e parashikuara nga Kushtetuta ose ligji i aplikueshëm.

#### Neni 36 [E Drejta e Privatësisë]

##### *E drejta për jetë private*

**KI113/21, Parashtruese e kërkesës: Bukurije Haxhimurati, vlerësim i kushtetueshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 29/2021 të 13 prillit 2021**

Autorizimi masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit rezultoi në “ndërrhyrje” në të drejtën për “jetë private” dhe “korrespondencë”, e cila mund të arsyetohet vetëm nëse plotësohen, në mënyrë kumulative, kushtet në vijim: (i) kufizimi të jetë “i përcaktuar në ligj”; (ii) të ndjek një “qëllim legjitim”; dhe (iii) nëse është “proporcionale”. Urdhri i një gjykate që autorizon retroaktivisht masa të fshehta dhe teknike të vëzhgimit, më specifikisht autorizimi i leximit të mesazheve SMS në mënyrë retroaktive, nuk është përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale, andaj kjo rezultoi në shkeljen e të drejtës së privatësisë së parashtrueses së kërkesës, në kundërshtim me garancitë e nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së: - shkelje e të drejtave kushtetuese

##### **Faktet**

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me dënimin e parashtrueses së kërkesës për veprën penale të “ushtrimin të ndikimit”, pasi që e njëjta, sipas vendimeve të gjykatave të rregullta, kishte pranuar

#### Çlan 36 [Pravo na privatnost]

##### *Pravo na privatni život*

**KI113/21, Podnositeljka zahteva: Bukurije Haxhimurati, ocena ustavnosti presude Vrhovnog suda Kosova Pml. br. 29/2021 od 13. aprila 2021. godine**

Ovlavšćenje skrivenih i tehničkih mera posmatranja i istrage rezultira “mešanjem” u pravo na “privatni život” i “prepisku”, koje može biti opravdano samo ako su kumulativno ispunjeni sledeći uslovi: (i) da je ograničenje “propisano zakonom”; (ii) da teži “legitimnom cilju”; i (iii) da je “srazmerno”. Naredba suda koja retroaktivno ovlašćuje skrivene i tehničke mere posmatranja, specifično retroaktivno ovlašćenje čitanja SMS poruka nije propisano Zakonikom o krivičnom postupku, što je dovelo do povrede prava na privatnost podnositeljke zahteva u suprotnosti sa garancijama iz člana 36. Ustava u vezi sa članom 8. EKLJP: povreda ustavnih prava.

##### **Činjenice**

Okolnosti ovog slučaja se odnose na kaznu podnositeljke zahteva za krivično delo “vršenje uticaja”, zato što je ista, prema odlukama redovnih sudova, primila određenu sumu novca kako bi uticala na donošenje odluke službenih lica u cilju ublažavanja ili oslobađanja od kazne osobe koja je osuđena za krivično delo. Što se tiče oglašavanja krivom podnositeljke zahteva, redovni sudovi su izveli niz dokaza, uključujući (i) čitanje svedočenja svedoka „C“; (ii) transkripte sasta-

ar një shumë të caktuar parash që të ushtrojë ndikim mbi vendimmarrjen e personave zyrtarë, me qëllim të zbutjes apo lirimit nga dënimi të një personi i cili ishte i dënuar për vepër penale. Lidhur me shpalljen fajtores të parashtrueses së kërkesës, gjykatat e rregullta kishin administruar një numër provash, duke përfshirë (i) leximin e dëshmisë së dëshmitarit “C”; (ii) transkriptet e takimeve të zhvilluara në mes të parashtrueses së kërkesës dhe dëshmitarit “C”; (iii) dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë dhe prova të tjera materiale; (iv) raportet e përgjimeve; dhe (v) një numër të mesazheve tekstuale SMS, të cilat ishin nxjerrë në mënyrë retroaktive me urdhër të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Gjatë procedurave të zhvilluara në gjykatat e rregullta, parashtruesja e kërkesës kishte kontestuar, mes tjerash, provat e shqyrtuara kundër saj, duke përfshirë (i) urdhrin e Gjykatës Themelore që autorizonte marrjen e SMS-ve në mënyrë retroaktive; dhe (ii) leximin e dëshmisë së dëshmitarit “C” të dhënë gjatë fazës hetimore, meqenëse i njëjti ishte shpallur dëshmitar i mbrojtur dhe rrjedhimisht nuk kishte dëshmuar në shqyrtimin kryesor, por ishte lexuar deklarata e tij. Gjykata e Apelit, respektivisht Gjykata Supreme, kishin hedhur poshtë këto pretendime, duke e vërtetuar dënimin e parashtrueses së kërkesës.

#### Ankesat e parashtrueses së kërkesës

Parashtruesja e kërkesës para Gjykatës pretendoi se, asaj i ishte cenuar e drejta për jetë private e garantuar me nenin 36të Kushtetutës lidhur me nenin 8 të KEDNJ-së, si dhe e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së sepse, mes tjerash: (i) Aktgjykimi i Gjykatës Themelore përkitazi me dënimin e saj ishte bazuar në prova të cilat ishin të paligjshme, konkretisht, SMS-ët që ishin nxjerrë në mënyrë retroaktive; dhe (ii) gjatë shqyrtimit kryesor nuk i ishte mundësuar marrja në pyetje e dëshmitarit “C”.

Gjetjet e Gjykatës

naka održanih između podnositeljke zahteva i svedoka „C“; (iii) svedočenja drugih svedoka i druge materijalne dokaze; (iv) izveštaje o prisluškivanju; i (v) jedan broj SMS tekstualnih poruka, koje su retroaktivno izdate po nalogu Osnovnog suda u Prištini.

Tokom postupaka sprovedenim pred redovnim sudovima, podnositeljka zahteva je osporila, između ostalog, dokaze koji su razmotreni protiv nje, uključujući (i) nalog Osnovnog suda kojim se retroaktivno odobrava uzimanje SMS poruka; i (ii) čitanje svedočenja svedoka “C” datog tokom istražen faze, pošto je isti proglašen zaštićenim svedokom i samim tim, nije svedočio na glavnom pretresu, ali je pročitana njegova izjava. Apelacioni sud, odnosno Vrhovni sud, su odbili ove navode, potvrdivši kaznu podnositeljke zahteva.

#### Žalbe podnositeljke zahteva

Podnositeljka zahteva je pred Sudom navodila da joj je povređeno pravo na privatnost zagarantovano članom 36. Ustava u vezi sa članom 8. EKLJP-a, kao i pravo na pravično i nepristrasno suđenje zagarantovano članom 31. Ustava u vezi sa članom 6. (Pravo na pravično suđenje) EKLJP-a, zato što je, između ostalog: (i) presuda Osnovnog suda u vezi sa njenom kaznom zasnovana na dokazima koji su bili nezakoniti, odnosno na SMS porukama koje su retroaktivno izdate, i (ii) tokom glavnog pretresa joj nije omogućeno ispitivanje svedoka „C”.

#### Nalazi Suda

Pri ocenjivanju navoda podnositeljke zahteva, Sud je, i na osnovu sudske prakse ESLJP-a, prvo istakao da se prisluškivanje telefona i SMS poruka smatra „uplitanjem“ u pravo na „privatnost“ i „prepisku“. Međutim, prema ESLJP-u, takvo „uplitanje“ je opravdano, ako je (i) „propisano zakonom“; (ii) teži „legitimnom cilju“; i (iii) ako je „proporcionalno“. Primjenjujući ova načela u okolnostima ovog slučaja, Sud je utvrdio da je izdavanje SMS poruka retroaktivno, odnosno naloga suda koji retroaktivno odobrava prikrivene i tehničke mere nadzora i istrage, bilo u suprotnosti sa odredbama Zakonika o krivičnom postupku, zato što takav nalog važi samo od „dana donošenja“ relevantne sudske odluke, a ne retroaktivno. Shodno tome,

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, Gjykata, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, fillimisht theksoi se përgjimi i telefonave dhe SMS-ve konsiderohet “ndërhyrje” në të drejtën për “jetë private” dhe “korrespondencë”. Megjithatë, sipas GJEDNJ-së, një “ndërhyrje” e tillë arsyetohet nëse e njëjta është (i) “e përcaktuar në ligj”; (ii) ndjek një “qëllim legjitim”; dhe (iii) nëse është “proporcionale”. Në aplikimin e këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret, Gjykata gjeti se nxjerrja e SMS-ve në mënyrë retroaktive, përkatësisht urdhri i një gjykate që autorizon retroaktivisht masa të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, ishte në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, pasi që një urdhër i tillë, vlen vetëm nga “data e lëshimit” të vendimit të gjykatës përkatëse dhe jo në mënyrë retroaktive. Për pasojë, Gjykata konstatoi se “ndërhyrja përkatëse” në jetën private të parashtrueses së kërkesës, nuk ishte e “përcaktuar në ligj”, përkatësisht ishte në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm, dhe rrjedhimisht, nuk ishte më tej i nevojshëm vlerësimi nëse në rrethanat e rastit konkret, mund të ketë pasur “qëllim legjitim” apo “proporcionalitet”. Për pasojë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata konstatoi që, në rrethanat e rastit konkret, vendimet e gjykatave të rregullta kishin rezultuar në shkeljen e të drejtës së privatësisë së parashtrueses së kërkesës, në kundërshtim me garancitë e nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së. Megjithatë, në trajtimin e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës për shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata theksoi se, konstatimi i shkeljes së të drejtës për privatësi, nuk rezulton domosdoshmërisht edhe në shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, për të arritur në një konstatim të tillë, Gjykata duhet të vlerësojë, nëse prova/dëshmia përkatëse, ka qenë e “vetme” dhe/ose “vendimtare” në përcaktimin e fajësisë,

Sud je utvrdio da „relevantno uplitanje“ u privatni život podnositeljke zahteva nije bilo „propisano zakonom“, odnosno bilo je u suprotnosti sa važećim zakonom, i shodno tome, više nije bilo potrebno oceniti da li je u okolnostima ovog slučaja možda postojao „legitiman cilj“ ili „proporcionalnost“. Shodno tome, na osnovu sudske prakse EKLJP-a, Sud je utvrdio da su, u okolnostima ovog slučaja, odluke redovnih sudova dovele do povrede prava na privatnost podnositeljke zahteva u suprotnosti sa garancijama člana 36. Ustava u vezi sa članom 8. EKLJP-a.

Međutim, u razmatranju navoda podnositeljke zahteva o povredi prava na pravično i nepristrasno suđenje, Sud je istakao da zaključak povrede prava na privatnost ne mora nužno da dovede i do povrede prava na pravično i nepristrasno suđenje. Na osnovu sudske prakse ESLJP-a, da bi se došlo do takvog zaključka, Sud mora da oceni da li su relevantni dokazi/iskazi bili „jedini“ i/ili „odlučujući“ u utvrđivanju krivice, odnosno kazne podnositeljke zahteva od strane redovnih sudova. U okolnostima ovog slučaja, Sud je ocenio da prisluškivanja/retroaktivna čitanja na osnovu nezakonite odluke Osnovnog suda, nisu bila „odlučujuća“ za oglašavanje krivom podnositeljke zahteva. Ovo zato što su presude redovnih sudova bile zasnovane, između ostalog, i na transkriptima sastanaka održanih između podnositeljke zahteva i svedoka „C“; iskazima drugih svedoka; prisluškivanjima uzetim na osnovu naloga relevantnog suda koji nisu osporeni od strane podnositeljke zahteva i drugih materijalnih dokaza. Pored toga i što se tiče svedočenja svedoka „C“, Sud je takođe istakao da na osnovu spisa predmeta, (i) podnositeljka zahteva i njen branilac su bili pozvani tokom ispitivanja svedoka „C“ u jednoj fazi postupka, ali su odbili da prisustvuju; i da (ii) svedočenje svedoka „C“, pročitano na glavnom pretresu, takođe nije bio „jedini“ i/ili „odlučujući“ dokaz za oglašavanje krivom podnositeljke zahteva.

#### Zaključak

Shodno tome i na osnovu objašnjenja datih u objavljenoj presudi, Sud je utvrdio da osporenim presudom Vrhovnog suda nisu povređene procesne garan-



përkatësisht dënimit të parashtrueses së kërkesës nga gjykatat e rregullta. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerësoi se përgjimet/leximi retroaktiv bazuar në një vendim të paligjshëm të Gjykatës Themelore, nuk ishin “vendimtare” për shpalljen fajtoresh të parashtrueses së kërkesës. Kjo sepse, aktgjykimet e gjykatave të rregullta ishin bazuar, mes tjerash, edhe në transkriptet e takimeve të zhvilluara ndërmjet parashtrueses së kërkesës dhe dëshmitarit “C”; dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë; përgjime të nxjerra bazuar në urdhra të gjykatës përkatëse e të cilat nuk ishin kontestuar nga parashtruesja e kërkesës dhe prova të tjera materiale. Për më tepër dhe përkitazi me dëshminë e dëshmitarit “C”, Gjykata gjithashtu theksoi se, bazuar në shkresat e lëndës: (i) parashtruesja e kërkesës dhe mbrojtësit e saj ishin të ftuar gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit “C” në një fazë të procedurës, por kishin refuzuar që të marrin pjesë; dhe se (ii) dëshmia e dëshmitarit “C”, e lexuar në shqyrtimin kryesor, gjithashtu nuk kishte qenë provë e “vetme” dhe/ose “vendimtare” për shpalljen fajtoresh të parashtrueses së kërkesës.

#### Përfundimi

Rrjedhimisht dhe bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk kishte shkelur garancitë procedurale të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, andaj i njëjti, sa i përket dënimit të parashtrueses së kërkesës, mbetet në fuqi. Ndërsa, përkitazi me konstatimin e shkeljes së të drejtës së privatësisë së parashtrueses së kërkesës në kundërshtim me garancitë e përcaktuara në nenin 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së, marrë parasysh që Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencën e akordimit të kompensimit, bazuar në praktikën e saj gjyqësore, kjo e fundit sqaroi se parashtruesja e kërkesës mund të shfrytëzoj mjetet juridike në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi, për realizimin e mëtejme të të drejtave të saj, duke

cije propisane u çlani 31. Ustava u vezi sa çlanom 6. EKLJP-a, stoga ista, što se tiče kazne podnositeljke zahteva, ostaje na snazi. Međutim, što se tiče utvrđivanja povrede prava na privatnost podnositeljke zahteva u suprotnosti sa garancijama propisanim u çlanu 36. Ustava u vezi sa çlanom 8. EKLJP-a, uzimajući u obzir da Ustavni sud nije nadležan da dodeljuje naknadu, na osnovu svoje sudske prakse, poslednje navedeni je objasnio da podnositeljka zahteva može da iscrpi pravna sredstva na raspolaganju prema zakonu na snazi za dalje ostvarivanje svojih prava, uključujući i pravo da traži naknadu materijalne štete kao rezultat povrede prava na privatnost koje je zagarantovano u çlanu 36. Ustava i çlanu 8. EKLJP-a.

përfshirë edhe të drejtën për të kërkuar kompensimin e dëmit material, si rezultat i shkeljes së të drejtës për jetë private të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së.

#### Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

##### *E drejta në pronë dhe markat tregtare*

**KI159/20, Parashtrues: ADOL sh.p.k., Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 29/19, të 1 korrikut 2020.**

Përkundër faktit që “e drejta në pronë” e përcaktuar në nenin 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, aplikohet lidhur me markat e regjistruara tregtare, kjo nuk përfshin ndalimin e importimit të mallrave të kompanisë tjetër, nëse të njëjtat përdorin “marka të mirënjohura” nëse kanë qenë të tilla edhe para regjistrimit formal të markës tregtare. Gjithashtu, përdorimi i simboleve kombëtare, nuk mund të përvetësohet duke u thirrur në regjistrimin e një marke tregtare që përmban simbol shtetëror: - jo shkelje e të drejtave kushtetuese.

#### Faktet

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me regjistrimin e markës tregtare “GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU”, nga ana e parashtruesit të kërkesës tek Agjencia për Pronësi Industriale (në tekstin e mëtejshëm: API). Për shkak të ngjashmërive me disa produkte të importuara nga kompania “ELKOS” dhe përdorimin e të njëjtës markë tregtare nga kjo e fundit, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi, si dhe kërkesë për masë të përkohshme në Gjykatën Themelore, duke pretenduar cenim të së drejtës në markë tregtare të parashtruesit të kërkesës. Në procedurat gjyqësore, padia e parashtruesit të kërkesës ishte refuzuar si e pabazuar sepse Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, vlerësuan ndër tjerash, se bazuar në Ligjin për

#### Çlan 46 [Zaštita imovine]

##### *Pravo na imovinu i trgovačke marke*

**KI159/20, Podnosilac: ADOL d.o.o, Ocena ustavnosti presude Rev. br. 29/19 od 1. jula 2020. godine Vrhovnog suda Kosova**

Uprkos činjenici da se „pravo na imovinu“, utvrđeno članom 46. Ustava u vezi sa članom 1. Protokola br. 1 EKLJP-a, primenjuje u vezi sa registrovanim trgovačkim markama, to ne obuhvata zabranu uvoza robe drugom preduzeću, ako isto koristi „priznate marke“, i koje su bile takve i pre formalne registracije trgovačke marke. Takođe, korišćenje nacionalnih simbola ne može se prisvojiti pozivanjem na registraciju trgovačke marke koja sadrži državne simbole: - nema povreda ustavnih prava.

#### Činjenice

Okolnosti konkretnog slučaja se odnose na registraciju trgovačke marke „GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU“ od strane podnosioca zahteva u Agenciji za industrijsku svojinu (u daljem tekstu: AIS). Zbog sličnosti sa nekim proizvodima koje uvozi preduzeće „ELKOS“ i korišćenja iste trgovačke marke od strane poslednje navedenog, podnosilac zahteva je podneo tužbu i zahtev za određivanje privremene mere Osnovnom sudu, navodeći povredu prava na trgovačku marku podnosioca zahteva. U sudskom postupku, tužba podnosioca zahteva je odbijena kao neosnovana, jer su Osnovni sud, Apelacioni sud i Vrhovni sud ocenili, između ostalog, da je na osnovu Zakona o trgovačkim markama i Pariske konvencije za zaštitu industrijske svojine, trgovačka marka koju koristi drugo preduzeće „priznata marka“ i sadrži i „državne simbole“, koje jedna strana ne može da prisvoji i njihovo korišćenje je zabranjeno drugim lici-

Markat Tregtare dhe Konventën e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, marka tregtare e përdorur nga kompania tjetër, është “markë e mirënjohur” dhe e cila gjithashtu përmban “simbole shtetërore”, të cilat nuk mund të përvetësohen nga një palë dhe përdorimi i tyre t’iu ndalohet palëve tjera.

#### Ankesa e parashtruesit të kërkesës

Parashtruesi i kërkesës pretendoi para Gjykatës se, gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke argumentuar, ndër tjera, se ai ka regjistruar markën tregtare tek API dhe si pasojë, bazuar në Ligjin për Markat Tregtare, atij i takojnë të gjitha të drejtat ligjore lidhur me të, duke pretenduar gjithashtu që vetëm API është kompetente të marr vendimin për të refuzuar aplikimin për regjistrim dhe/ose shpalljen e markës së regjistruar tregtare si të pavlefshme.

#### Gjetjet e Gjykatës

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht shtjelloi parimet e përgjithshme të praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së përkitazi me të drejtën në pronë dhe pastaj aplikoi të njëjtat në rastin konkret. Lidhur me këtë, Gjykata konstatoi se “e drejta në pronë” e përcaktuar në nenin 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, aplikohet lidhur me markat e regjistruara tregtare. Në këtë kontekst, Gjykata bazuar në praktikën e lartcekur gjyqësore, së pari analizoi nëse në rastin konkret ka pasur “ndërhyrje” në të drejtën e tij “në pronë” dhe nëse vlerësimi i gjykatave të rregullta në këtë aspekt ka qenë arbitrar. Lidhur me këtë, Gjykata vlerësoi se gjykatat e rregullta iu referuan dy kategorive të arsyetimeve mbi bazën e ligjeve të aplikueshme, për të refuzuar padinë e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht (a) markave të mirënjohura; dhe (b)

#### Žalba podnosioca zahteva

Podnosilac zahteva je pred Sudom navodio da su mu redovni sudovi povredili prava zagaranтовana članom 46. Ustava u vezi sa članom 1. (Zaštita imovine) Protokola br. 1. EKLJP-a i članom 54. [Sudska zaštita prava] Ustava u vezi sa članom 6. EKLJP-a, tvrdeći, između ostalog, da je trgovačku marku registrovao kod AIS-a, i shodno tome, na osnovu Zakona o trgovačkim markama, ima sva zakonska prava u vezi sa tim, navodeći da je samo AIS nadležan da donese odluku o odbijanju prijave za registraciju i/ili proglašenje registrovane trgovačke marke nevažećom.

#### Nalazi Suda

Ocenjujući navode podnosioca zahteva, Sud je prvo razradio opšta načela svoje sudske prakse i načela ESLJP-a u pogledu prava na imovinu, a zatim ih je primenio na konkretan slučaj. S tim u vezi, Sud je utvrdio da se „pravo na imovinu“ definisano članom 46. Ustava u vezi sa članom 1. Protokola br. 1 EKLJP-a, primenjuje na registrovane trgovačke marke. U tom smislu, Sud je, na osnovu gore navedene sudske prakse, prvo analizirao da li je u konkretnom slučaju došlo do „uplitanja“ u njegovo pravo na „imovinu“ i da li je ocena redovnih sudova u vezi s tim bila proizvoljna. S tim u vezi, Sud je ocenio da su se redovni sudovi pozvali na dve kategorije obrazloženja na osnovu važećih zakona da odbiju tužbu podnosioca zahteva, odnosno na (a) priznatu marku; i (b) korišćenje državnih simbola.

Sud je, analizirajući obrazloženje redovnih sudova, utvrdio da su poslednje navedeni, u suštini, primenili, između ostalog, relevantne odredbe Zakona o trgovačkim markama i relevantne odredbe međunarodnih instrumenata i koje posebno regulišu pitanje „priznatih trgovačkih maraka“, te su u tom slučaju utvrdili da podnosilac zahteva ne može zabraniti uvoz robe drugog preduzeća, budući da se radi o „priznanim markama“, a to su bile i pre formalne registracije trgovačke marke od strane podnosioca zahteva u AIS-u. Pored toga i u pogledu upotrebe državnih simbola, Sud je ocenio da su redovni sudovi, primenjujući relevantne odredbe međunarodnih instrumenata, a koji posebno regulišu pitanje nacionalnih i državnih sim-

përdorimit të simboleve kombëtare.

Gjykata, në analizimin e arsyeve të gjykatave të rregullta, gjeti se këto të fundit, në esencë, kanë zbatuar, mes tjerash, dispozitat përkatëse të Ligjit për Marka Tregtare dhe dispozitat relevante të instrumenteve ndërkombëtare dhe të cilat specifikisht rregullojnë çështjen e “markave të mirënjohura” dhe me këtë rast, kanë konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk mund të ndalojë importimin e mallrave të kompanisë tjetër, meqenëse ato janë “marka të mirënjohura” dhe ishin të tilla edhe para regjistrimit formal të markës tregtare nga parashtruesi i kërkesës në API. Për më tepër dhe sa i përket përdorimit të simboleve kombëtare, Gjykata vlerësoi se gjykatat e rregullta, duke zbatuar dispozitat relevante të instrumenteve ndërkombëtare dhe të cilat specifikisht rregullojnë çështjen e simboleve kombëtare dhe shtetërore, kishin theksuar se që të dy kompanitë përdorin në produktet e tyre elemente të flamurit dhe të stemës kombëtare të Republikës së Shqipërisë, dhe se ky fakt përbën një karakteristikë përmes së cilës i pamundësohet përvetësimi i këtij simboli si markë tregtare nga parashtruesi i kërkesës dhe që në rrethana të rastit konkret, kjo nënkupton që palës tjetër nuk mund t’i ndalohet përdorimi i kësaj shenje.

#### Përfundimi

Për rrjedhojë dhe bazuar në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar [Rev. nr. 29/19] i 1 korrikut 2020 i Gjykatës Supreme, nuk është nxjerrë në shkelje të nenit 46 (Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

bola, istakli da dva preduzeća u svojim proizvodima koriste elemente zastave i državnog grba Republike Albanije i da ova činjenica predstavlja karakteristiku kojom je nemoguće da podnosilac zahteva prisvoji ovaj simbol kao trgovačku marku, te da u okolnostima konkretnog slučaja to znači da drugoj strani ne može biti zabranjeno da koristi taj znak.

#### Zaključak

Shodno tome i na osnovu objašnjenja datih u objavljenom presudi, Sud je utvrdio da osporena presuda [Rev. br. 29/19] od 1. jula 2020. godine Vrhovnog suda nije doneta uz povredu člana 46. (Zaštita imovine) Ustava u vezi sa članom 1. (Zaštita imovine) Protokola br. 1 EKLJP-a.

